

Zineta Asani¹

UDC: 347.965.42:340.13(497.7)

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË NDËRMJETËSIMIT SI
PROCEDURË ALTERNATIVE PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE - ME
THEKS TË VEÇANTË NË MAQEDONINË E VERIUT**

**ОПШТИ АСПЕКТИ НА МЕДИЈАЦИЈАТА КАКО АЛТЕРНАТИВНА
ПОСТАПКА ЗА РЕШАВАЊЕ СПОРОВИ - СО ПОСЕБЕН АКЦЕНТ
НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**GENERAL ASPECTS OF MEDIATION AS AN ALTERNATIVE
PROCEDURE FOR RESOLVING DISPUTES - WITH SPECIAL
EMPHASIS ON NORTH MACEDONIA**

Abstract

Mediation as a legal institution represents an alternative method for resolving disputes between legal subjects. It is known as flexible dispute resolving process in which a mediator acts as a neutral person who helps the parties reach a consensus solution to their dispute. Based on the practices of the countries of the region and the countries of the EU, mediation finds wide application in the fields of law, especially in civil disputes, but as a mandatory mediation provided in the legislation of these countries. So, mediation is a valuable method of dispute resolution that deserves promotion, therefore it is a public policy priority for many states, regional and international organizations.

As an extrajudicial activity in the Republic of North Macedonia, it is regulated by the Law on Mediation approved since 2006 and subsequently with its amendments and additions until 2022, when it entered into force as a new law in the national legislation. It is recognized as a specialized activity that is faster, easier and cheaper than judicial procedures and as a reliable legal mechanism of alternative dispute resolving and high quality and professional services. Not knowing the benefits, not affirming mediation was one of the reasons why it was not used enough in our country.

¹ Ass. Profesor, AUE -FON University, Skopje. Email: zinet.asani@fon.edu.mk

The focus of this paper will be the elaboration of Mediation in the legislation of the Republic of North Macedonia, and special attention will be emphasis to the manner of its implementation, its priorities for the parties and in general for the legal system.

Keywords: *mediation, Mediation Law, civil disputes, subjects of the right.*

1. Korniza juridike e ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Ndërmjetësimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i rregulluar që nga viti 2006, kur hyri në fuqi Ligji i parë për ndërmjetësim². Në fund të vitit 2013, u miratua një ligj krejtësisht i ri, i cili hyri në fuqi nëntë muaj pas miratimit, d.m.th në tetor të vitit 2014. Në dhjetor të vitit 2021 në Gazetën Zyrtare të RMV shpallet Ligji i ri për ndërmjetësim që hyri në fuqi në 1 janar të vitit 2022³. Me këtë ligj rregullohet ndërmjetësimi në marrëdhëniet kontestuese ku palëve u mundësohet lirshëm të disponojnë kërkesat e tyre, përveç nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar kompetencë ekskluzive e gjykatës ose organit tjetër, pa marrë parasysh nëse ai zbatohet para ose pas fillimit të procedurës gjyqësore ose lloj tjetër procedure⁴. Qëllimi i këtij ligji është lehtësimi i qasjes në procedurat e ndërmjetësimit si procedurë alternative për zgjidhjen e kontesteve, të ngritjes së vetëdijes për ndërmjetësim, me nxitjen e zbatimit të tij dhe nëpërmjet garantimit të lidhjes së balancuar në mes ndërmjetësimit dhe procedurës gjyqësore. Referuar qëndrimit që mban Ligji për ndërmjetësim, ai e përkufizon atë si një veprimtari jashtëgjyqësore. Kjo nënkupton që një proces ndërmjetësimi zhvillohet në mënyrë të pavarur nga sistemi gjyqësor. Ky proces është tërësisht vullnetar si nga pikëpamja e përzgjedhjes së tij si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, por edhe në zgjedhjen e ndërmjetësit, dhe deri në pranimin ose jo të marrëveshjes së propozuar. Ndërmjetësi në krahasim me gjyqtarin apo arbitrin nuk ka fuqi të imponojë një zgjidhje për mosmarrëveshjen e palëve. I njëjti qëndrim mbahet edhe në Direktivën⁵ e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për institutin e ndërmjetësimit, i cili përkufizohet si një proces i strukturuar, në të cilën dy apo më shumë palë mbi baza vullnetare kërkojnë të arrijnë një marrëveshje për mosmarrëveshjet e tyre me ndihmën e një pale të tretë (ndërmjetësit).

² Ligji për ndërmjetësim në RM, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.60/2006

³ Me këtë Ligj bëhet harmonizimi me Direktivën 2008/52/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 21 maj 2008 lidhur me aspekte të caktuara të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe ekonomike. CELEX nr. 32008L0052.

⁴ Neni 1 i Ligjit për ndërmjetësim të RMV, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 294/2021

⁵ Neni 7/1 (a) dhe (b)- Direktiva 2008/52/EC Nr.CELEX 3200810052 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të 21 Majit 2008 “Mbi disa aspekte të Ndërmjetësimit në çështjet civile dhe ekonomike”.

Bazuar në periudhën e mëhershme të zbatimit të ndërmjetësimit në praktikë, si mjet alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ndërmjetësimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka gjetur zbatim të gjerë në praktikë, dhe nevoja për zbatimin e tij buron nga situata aktuale në të cilën gjendet sistemi gjyqësor vendas. Në këtë kontest vlen të potencohet se, më shumë se gjashtë vjet pas miratimit të Ligjit për ndërmjetësim, koncepti i ndërmjetësimit nuk tregoi ndonjë rezultat të dukshëm. Në thelb, numri i lëndëve të zgjidhura në procedurën e ndërmjetësimit ka qenë i pakënaqshëm me një numër relativisht modest. Praktika ka treguar se krahasuar me vendet që zbatojnë ndërmjetësimin e detyrueshëm, koncepti maqedonas i ndërmjetësimit alternativ nuk e justifikon atributin e ndërmjetësimit praktik dhe funksional. Në kushtet e ekzistencës së sistemeve funksionale relativisht të avancuara dhe efikase të ushtrimit të ndërmjetësimit të detyrueshëm, ekzistojnë mundësi reale për ndryshimin e kodit mendor dhe zhveshje në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të mënyrave dhe formave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në thelb nuk mjaftojnë vetëm parametrat deklarativë të vullnetarizmit dhe mosdetyrimit, por duhet përdorur edhe forma ligjore e detyrueshme, e cila sipas definicionit përcakton detyrimin e secilës palë për të bërë më shumë përpjekje. Vlen të potencohet rëndësia që ka gjetur zbatimi i ndërmjetësimit në praktikat e disa vendeve të rajonit, vendeve të BE-së dhe jashtë kontinentit si: SHBA, Kanada dhe Australia si vende me ndërmjetësim të zhvilluar, Italia, një nga vendet e BE-së me ndërmjetësim të praktikuar fuqishëm, Sllovenia si vendi i parë nga ish-komuniteti federal i cili zyrtarisht dhe ligjërisht filloi ndërmjetësimin shumë vjet më parë dhe Mali i Zi, i cili ju përgjigjej sfidave moderne dhe mënyrave efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësimit. Në SHBA ku ndërmjetësimi është i detyrueshëm, sipas treguesve statistikorë, vetëm 5% e rasteve përfundojnë në procedurë gjyqësore formale, ndërsa pjesa tjetër 95% i nënshtrohen procedurës së ndërmjetësimit, për faktin që procedurat gjyqësore të zhvillohen vetëm në rastet kur çështja nuk mund të zgjidhet me ndërmjetësim⁶. Në Kanada, për shembull, rreth 75% e çështjeve zgjidhen me zgjidhje gjyqësore dhe rreth 50% e çështjeve zgjidhen me ndërmjetësim të detyrueshëm, gjë që tregon një rezultat të shkëlqyer për ndërmjetësim⁷. Në Australi, ndërmjetësimi është gjithashtu i detyrueshëm, ngjashëm me SHBA-në dhe Kanadanë, dhe rezultatet e ndërmjetësimit janë të ngjashme me ato në Kanada. Në Itali, koncepti i një përpjekjeje të detyrueshme për ndërmjetësim ka funksionuar me sukses në praktikë për disa vjet. Në Mal të Zi në Ligjin për

⁶ Kalifornia miratoi Aktin e Ndërmjetësimit në 1998 për të rregulluar ndërmjetësimin në mosmarrëveshjet civile, ligjin familjar dhe ligjin e punës. Palët në procedurën e ndërmjetësimit duhet të përgatiten dhe të qëndrojnë të pranishme dhe të marrin pjesë në ndërmjetësim deri në arritjen e marrëveshjes ose deri në përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit.

⁷ Që nga fillimi i janarit 2010, si pjesë e ndryshimeve të gjera në Aktin e Procedurës Civile, është zbatuar Rregullorja 24.1, ku përpjekja e detyrueshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet me ndërmjetësim mbulon të gjitha mosmarrëveshjet e filluara në Otava, Toronto dhe Essex.

Familjen⁸ është futur një përpjekje e detyrueshme për ndërmjetësim në kontestet familjare, që paraqet një progres të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në Mal të Zi. Gjithashtu edhe në Republikën e Sllovenisë kjo parashihet në nenin 19 të Ligjit për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve. Prandaj, është më se e qartë se mund të theksohet nevoja për një qasje serioze më të gjerë institucionale të shoqërisë dhe palëve të interesuara për të modifikuar konceptin dhe për të futur përpjekjen e detyrueshme të ndërmjetësimin në vendin tonë.

Ndërmjetësimi në pajtim me Ligjin e Ri hasi në ndryshime dhe plotësime të cilat kishin për qëllim të arrihet një nivel më i lartë i vetëdijesimit tek qytetarët që mosmarrëveshjet midis tyre t'i zgjidhin në këtë procedurë, që në krahasim me procedurën gjyqësore klasike ka avantazhe më të larta. Ndërmjetësimi sipas ligjit në fjalë gjen zbatim në mosmarrëveshjet pronësore që lindin nga procedurat e verifikimit, mosmarrëveshjet familjare, mosmarrëveshjet e punës, kontestet tregtare, mosmarrëveshjet konsumatore, mosmarrëveshjet e sigurimit, mosmarrëveshjet që lindin nga procedurat e urdhërpagesës nga noteri, mosmarrëveshjet në fushën e arsimit, mosmarrëveshjet në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, mosmarrëveshje në fushën e kujdesit shëndetësor, në mosmarrëveshje në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mosmarrëveshje në lidhje me diskriminimin, mosmarrëveshje në lidhje me përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje dhe në marrëdhënie të tjera kontestuese. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në çështjet penale, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore⁹ me nenin 47 të ligjit, është bërë ndryshimi në nenin 461 të tekstit ligjor, sipas të cilit “në kontestet ekonomike për kërkesën në të holla vlera e së cilës nuk kalon 1.000.000 denarë, dhe për të cilën procedura është inicuar me padi në gjykatë, palët janë të obliguara që para ngritjes së padisë të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshja me ndërmjetësim. Me rastin e paraqitjes së padisë, paditësi është i detyruar të paraqesë prova të nxjerra nga ndërmjetësi se përpjekja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim ka dështuar. Gjykata do ta refuzojë padinë së cilës nuk i janë bashkangjitur provat nga paragrafi (2) i këtij neni.” Kjo dispozitë e LPK ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2016.

1.1 Fushat e zbatimit të ndërmjetësimin sipas Ligjit për ndërmjetësim

Ndërmjetësimi gjen zbatim të gjerë në të drejtën bazuar në veprimtarinë e tij të specializuar më të shpejtë, më të lehtë dhe më të lirë se procedurat gjyqësore dhe si mekanizëm i besueshëm ligjor i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe shërbimeve të larta cilësore dhe profesionale¹⁰.

⁸ Neni 326, 327 dhe 328 i Ligjit për familje i Malit të Zi, Gazeta zyrtare, nr.1/07.

⁹ Ligji për ndryshim dhe plotësimin e procedurës kontestimore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 124./15

¹⁰ Кирил Чавдар & Кимо Чавдар - Закон за парнична постапка со коментари, судска практика, примери од практична примена и предметен регистар, Shkup, 2016.

Siç u përmend paraprakisht zbatimi i ndërmjetësimit shtrihet në shumë sfera dhe atë: në kontestet pronësore që kanë rrjedhën e tyre gjatë procedurës së trashëgimisë, kontesteve familjare, të punës, tregtare, kontesteve të konsumit, të sigurimit, kontesteve të cilat dalin nga procedura e urdhërpagesave të noterit, në fushën e arsimit, kontesteve në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, në fushën e mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes së mjedisit jetësor, kontesteve në lidhje me diskriminimin, kontesteve të ndërlidhura me përgjegjësinë civile për fryrje dhe shpifje si dhe në marrëdhënie tjera kontestuese ku ndërmjetësimi i përgjigjet natyrës së marrëdhënieve kontestuese dhe mund të ndihmojë për zgjidhjen e tyre mes personave fizik dhe juridik vendor dhe të huaj¹¹. Ligji parasheh edhe zgjidhjen e kontesteve me ndërmjetësim edhe në lëndët penale, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe. Ndërmjetësimi, nga ana tjetër nuk mund të zbatohet për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve: shkurorëzimi i martesës, vërtetimi apo kontestimi i atësisë ose amësisë, procedurat e statusit për falimentim dhe likuidim, procedurat jashtëgjyqësore, të cilat absolutisht edhe nuk konsiderohen si kontestuese dhe inicohen me propozim (ndarje fizike, rregullimin e kufijve pronësorë, procedurat trashëgimore, përcaktim i kompensimit për pronën e shpronësuar, trajtim i detyrueshëm në institucion shëndetësor apo në liri, shpallja e personit të zhdukur për të vdekur, dhënia e lejes martesore për të mitur) dhe raste tjera të kontesteve, i cili ndërmjetësim nuk do të ishte i përshtatshëm për të zgjidhur një mosmarrëveshje të caktuar.

1.2 Nocioni dhe Parimet e Ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi, si një mënyrë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfaqëson veprimtari jashtëgjyqësore në të cilën palëve në marrëdhënien kontestuese u jepet e njëjta mundësi për ta zgjidhur çështjen përmes negociatave, në mënyrë paqësore, me ndihmën e një ose më shumë ndërmjetësve të licencuar, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht, të shprehur në formën e një marrëveshjeje me shkrim¹². Ndërmjetësimi, si i tillë, plotëson procedurën gjyqësore dhe palët mund të hyjnë në dispozitat e marrëveshjes detyruese reciproke që i detyrojnë ato në rast mosmarrëveshjeje, të përpiqen ta zgjidhin marrëdhënien e kontestuar përmes negociatave të drejtpërdrejta para fillimit të procedurës gjyqësore ose të procedurave të tjera për mbrojtje juridike. Karakteristikë e veçantë e ndërmjetësimit është liria e komunikimit të palëve, pra, me ndërmjetësim palëve u mundësohet deklarimi i tyre jo i dhunshëm në komunikim, toleranca midis palëve dhe mirëkuptimi i ndërsjellë.

Fillimi, ecuria dhe përfundimi i ndërmjetësimit bëhet në faza të njëpasnjëshme bazuar në disa parime me relevancë që duhet zbatuar me qëllim

¹¹ Neni 2 i LN të RMV

¹² Ligji për ndërmjetësim i RM-së “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 188/2013

që epilogu i ndërmjetësimit të arrijë qëllimin e duhur. Ndërmjetësi siguron zbatimin e këtyre parimeve në negociata: parimin e vullnetarizmit, neutralitetit dhe konfidencialitetit, barazisë të palëve, efikasitetit dhe drejtësisë.

- **Vullnetarizmi** - si parim nënkupton se procedura e ndërmjetësimit kryhet në bazë të pëlqimit të palëve të shprehur në formë të shkruar, përveç në marrëdhëniet kontestuese ku ndërmjetësimi, me ligj të veçantë, është paraparë si kusht për zhvillimin e procedurës gjyqësore ose të procedurës tjetër.

- **Barazia ndërmjet palëve** - si parim i procedurës së ndërmjetësimit do të thotë, që palët në procedure janë në baza të barabarta dhe asnjëra nga palët nuk mund të vendoset në një pozicion më të favorshëm se pala tjetër, në bazë të statusit të saj social, gjendjes materiale dhe financiare, kualifikimeve arsimore dhe të ngjashme. Ndërmjetësi është i detyruar të sigurojë pozicionin e barabartë të palëve në procedurë.

- **Neutraliteti** - si parim në ndërmjetësim nënkupton aktivitetin e ndërmjetësit i cili në procedurë është i detyruar të veprojë në mënyrë të paanshme, objektive në kuadër të palëve apo marrëdhënies kontestuese.

- **Konfidencialiteti** - nënkupton që të gjithë informacionet që dalin ose që rrjedhin ose lidhen me procedurën e ndërmjetësimit, duhet të mbeten të besueshme, përveç nëse palët kanë vendosur ndryshe. Gjithashtu, palët, përfaqësuesit dhe përfaqësuesit e tyre me prokurë, ndërmjetësit dhe palët e treta që marrin pjesë në proces, duhet të mbajnë sekret të gjitha të dhënat, propozimet dhe deklaratat dhe të mbajnë përgjegjësi për dëmin që mund të shkaktohet nëse shkelet ky detyrim.

- **Efikasiteti** - procedura e ndërmjetësimit është ndër procedurat më të shpejta dhe më efikase, procedurë në të cilën palët kanë qasje më të lehtë dhe të barabartë, që do të thotë se respektohet parimi i efikasitetit.

- **Drejtësia** - si parim mundëson dhe garanton trajtimin e drejtë, mënyra se si palët inkurajohen nga ndërmjetësi për bashkëpunim të plotë dhe të drejtë gjatë procedurës dhe të sigurojnë informacione për një zgjidhje të drejtë të marrëdhënies së kontestuar¹³.

2. Fazat e zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësimit fillon në ditën kur palët në mosmarrëveshje kanë rënë dakord me shkrim për të marrë pjesë në ndërmjetësim apo me nënshkrimin e deklaratës për pëlqim që do të marrin pjesë në ndërmjetësim, deklaratë e dhënë në procesverbal para gjykatës. Pala e cila konsideron se ekziston marrëdhënie kontestuese i dërgon një thirrje me shkrim palës tjetër ose më shumë palëve nëse janë përfshirë në ndërmjetësim, nëpërmes ndërmjetësit të licencuar. Në afat kohor prej shtatë ditëve nga marrja e ftesës për ndërmjetësim, pala e ftuar duhet të paraqitet në një takim me ndërmjetësuesin ose në një

¹³ Neni 14 ILN

takim të përbashkët me ndërmjetësuesin dhe palën që ka dërguar ftesën për ndërmjetësim¹⁴. Nëse në takim njëra nga palët nuk është dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmes procesit të ndërmjetësimit, e njëjta do të konfirmohet me shkrim.

2.1 Rrjedha e procedurës së ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësimit realizohet në disa faza: krijimi i bazës juridike për iniciimin e ndërmjetësimit; iniciimi dhe fillimi i procedurës; rrjedha e procedurës; përfundimi i procedurës me marrëveshje të suksesshme apo jo të suksesshme;

Fillimit të procedurës i prijnë paraprakisht negociatat që zhvillohen midis ndërmjetësit dhe palëve në kontest me ç’rast palët njoftohen për të gjithë rregullat që do të kontribuojnë në zgjedhjen konstruktive të mosmarrëveshjes. Rregullat të cilat duhet të respektojnë palët në proces janë:

- palët duhet të jenë të sinqertë në qëllimin për të tejkaluar mosmarrëveshjen;
- të jenë të hapur në komunikim dhe të dëgjojnë palën tjetër bashkëbiseduese;
- të respektojnë nevojat e bashkëbiseduesit;
- të jenë të përgatitur të identifikojnë dhe të definojnë burimin e kontestit;
- qartë të tregojnë qëllimin se pse e kanë kaq të rëndësishme të tejkalojnë kontestin;
- të mos kërkohej fajtori i kontestit;
- palët t’i përmbahen temës që duhet të zgjidhet;
- të shfaqin dëshirën për pranimin e ndryshimeve, vendosjes dhe durimit;

Negociatat janë pjesa thelbësore e procedurës të ndërmjetësimit e cila përmban tri subjekte.

Ndërmjetësin e licencuar dhe dy palët në kontest edhe pse varësisht nga kontesti mund të marrin pjesë edhe më shumë palë. Ndërmjetësi është personi që udhëheq procedurën dhe vazhdimisht duhet t’i kontrollojë palët dhe t’i drejtojë ata në fazën e negociatave, në të cilën ata i parashtrojnë qëndrimet e tyre, nevojat dhe interesat e tyre me qëllim arritjen e një zgjidhje pozitive.

Ndërmjetës mund të jetë personi fizik me aftësi të plotë veprimi i cili posedon licencë për kryerjen e punëve të ndërmjetësimit. Licenca për ndërmjetësim i lëshohet personit që e jep provimin për kontrollimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të ndërmjetësimit para Bordit për sigurimin, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së punës së ndërmjetësimit. Gjithashtu do të paraqesë kontratën e lidhur për sigurim nga përgjegjësia për dëme në

¹⁴ Neni 15 parag.3 i LN

pajtim me nenin 24 paragrafi 4 të këtij ligji. Licenca e lëshuar është e vlefshme për pesë vjet dhe mund të vazhdohet ose revokohet në varësi të rezultateve të vlerësimit të cilësisë së punës së ndërmjetësuesit. Vlerësimin e cilësisë së punës së ndërmjetësuesve e kryen Bordi së paku një herë në pesë vjet në përputhje me metodologjinë dhe procedurën për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së punës së ndërmjetësuesve. Formën dhe përmbajtjen e licencës për ndërmjetësues e përcakton Ministri i drejtësisë.

2.1.2 Fazat e zhvillimit të procedurës të ndërmjetësimit

Faza e parë

Parakusht që të mundësohet rrjedha e procedurës së ndërmjetësimit është ekzistimi adekuat i bazës juridike, që do t'ju mundësojë palëve në kontest të drejtë por edhe detyrim, që të tentojnë që mosmarrëveshja e tyre nëpërmes ndërmjetësimit të zgjidhet në mënyrën e duhur. Për rrjedhën e procedurës së ndërmjetësimit është i nevojshëm ekzistimi i këtyre bazave juridike:

- pajtueshmëria e vullnetit të të gjithë palëve në kontest për iniciimin e procedurës së ndërmjetësimit;
- dispozitë në aktin juridik që rregullon marrëdhënien reciproke, sipas të cilës ndërmjetësimi parashihet si mënyrë e zgjidhjes të kontesteve të cilat mund të burojnë nga marrëdhënia e tillë juridike;
- deklaratë për pajtueshmëri e dhënë në procesverbal para gjykatës, edhe në rastet kur për çështjen kontestuese rrjedh procedura gjyqësore;
- ligji;

Përcaktimi i bazave juridike është i rëndësishëm sepse prej tyre burojnë të drejta dhe detyrime të ndryshme për palët në kontest. Pra, dallimi më i rëndësishëm është se kur realizimi i ndërmjetësimit parashikohet me ligj ose kur palët janë angazhuar për të në një akt juridik, i cili rregullon marrëdhënien e tyre, realizimi i ndërmjetësimit është jo vetëm një e drejtë, por edhe një kusht që duhet të plotësohet. Në mënyrë që të jetë në gjendje që secila palë të fitojë të drejtën për të inicuar procedura gjyqësore, arbitrazh ose procedura të tjera.

Faza e dytë

Procedura e ndërmjetësimit fillon me dërgesën e thirrjes me shkrim dhe deklaratë palës tjetër nga ana e ndërmjetësit të licencuar¹⁵. Nëse ekziston ndonjë nga arsyet e mësipërme, palët mund të fillojë procedurën e ndërmjetësimit. Pala tjetër mund të pranojë ose të refuzojë të hyjë në ndërmjetësim. Pasi të fillojë procesi i ndërmjetësimit, ai duhet të përfundojë në afat kohor prej 60 ditësh. Është e nevojshme që palët të njihen me dy efekte të rëndësishme të cilat duhet t'i posedojë procedura gjatë fillimit të saj. Efekti thelbësor qëndron

¹⁵ <https://www.akademik.mk/mirno-reshavanje-na-sporovi-obrazets-za-barane-za-medijatsija-i-obrazets-za-polnomosh-no-zastapuvane/>

se, prej fillimit të procedurës e deri në mbarimin e saj, palët nuk mund të zhvillojnë procedurë para gjykatës, arbitrazh apo procedurë tjetër për kontestin e njëjtë. Edhe nëse ka filluar procedurë gjyqësore ajo duhet pezulluar. Efekti i dytë i rëndësishëm është se, me fillimin e procedurës për ndërmjetësim vjen deri tek ndalimi i rrjedhës të afateve për parashkrim, dhe për këtë nuk ekziston arsyeja që palët të frikësohen se ekziston rreziku për parashkrimin e të drejtave të tyre, ndërkohë që ata janë në pritje të përfundimit të ndërmjetësimit.

Palët në procedurën e ndërmjetësimit përfaqësojnë interesin e tyre personalisht nëse bëhet fjalë për person fizik, apo nëpërmes përfaqësuesit ligjor apo personin e autorizuar-avokati, nga personi juridik si palë në kontest. Përfaqësuesi i autorizuar do t'i përfaqësojë interesat e palës në kuadër të kornizës të autorizimeve të cilat i janë dhënë për negociatat të cilat do të zhvillohen në të gjithë fazat e procedurës të ndërmjetësimit. Roli i avokatit si përfaqësues është crucial, veçanërisht gjatë zgjidhjes të kontesteve ekonomike, duke pasur parasysh se këta konteste janë paraparë dhe janë rregulluar para së gjithash në Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve¹⁶ dhe Ligjin për procedurën kontestimore¹⁷, si një ndër mekanizmat themelore ligjore të cilat i shfrytëzojnë avokatët në veprimtarinë e tyre¹⁸.

Faza e tretë

Kjo fazë është pjesa kryesore e procedurës, ku palët e përfshira, përmes negociatave dhe me ndihmën e një ndërmjetësi të licencuar, përpiqen të kapërcëjnë mosmarrëveshjet e tyre në lidhje me çështjet e kontestueshme. Në këtë fazë kërkohet të arrihet një zgjidhje e pranueshme reciproke duke u fokusuar në interesat e përbashkëta. Para se të hyjnë në negociata, palët duhet të përcaktojnë numrin e ndërmjetësve dhe personave që do ta kenë atë rol. Nëse nuk mund të bien dakord për këtë, mund t'i drejtohen Dhomës së Ndërmjetësuesve¹⁹ e cila do t'i zgjidhë këto çështje. Përveç kësaj, palët kanë liri të plotë për të rregulluar mënyrën se si do të zhvillohet procedura. Në rrjedhën e negociatave, palët luajnë rolin qendror, ndërsa ndërmjetësi me njohuritë dhe aftësitë e tij lehtëson procesin. Kështu, hapin e parë që është i nevojshëm të marrë ndërmjetësi është që t'i njoftojë palët me qëllimet e ndërmjetësimit, rolin e ndërmjetësuesit dhe kostot e ndërmjetësimit. Për më tepër, gjatë gjithë procedurës, me njohuritë e tij eksperte, kontribuon në tejkalimin e konflikteve,

¹⁶ Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09.

¹⁷ Ligji për procedurën kontestimore i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 79/05, 110/08, 83/09, 116/10, 124/15.

¹⁸ Роза Алексова (медијатор), Неколку корисни информации за постапката на медијација во Македонија, [https:// goo.gl/UxVj5e](https://goo.gl/UxVj5e)

¹⁹ Вучев, З. Петковиќ, Г. Атанасова, Д. Јанкова, „Прирачник за обука на медијатори за обновување на знасњата за медијација”, Институт за европска политика – Shkup, qershor 2013, f. 18-19

përmirësimin e atmosferës dhe zhvillimin e një dialogu konstruktiv. Në këtë cilësi, ndërmjetësi ka të drejtën dhe detyrimin që të takohet me të dyja palët së bashku ose veçmas, por edhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Palët gjithashtu mund të bëjnë propozimet e tyre gjatë gjithë procedurës. Është e rëndësishme të theksohet se propozimet, si dhe të gjitha pikëpamjet e tjera të shprehura në procedurën e ndërmjetësimit, janë rreptësisht konfidenciale dhe nuk mund të përdoren nëse ekziston një procedurë gjyqësore apo ndonjë lloj tjetër e procedurës.

Faza e katërt

Faza e katërt e procedurës së ndërmjetësimit konsiston në arritjen e disa përfundimeve të procedurës:

- ***situatë fitim-humbje*** - sipas të cilës palët e kuptojnë kontestin si një luftë për të fituar, pra për të fituar një avantazh ndaj palës tjetër. Ata mendojnë dhe besojnë se gjithmonë kanë të drejtë, dhe të gjitha informacionet e tjera janë të parëndësishme. Qasja karakterizohet nga një përpjekje për të arritur qëllimet, sesa për të ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet palëve;

- ***situatë humbje-humbje*** - ku palët heqin dorë nga qëllimet që dëshironin të arrinin dhe anulojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes duke pretenduar se mosmarrëveshja nuk ekziston;

- ***situatë fitim-humbje*** - karakterizon përfundimin e negociatave, gjatë të cilave ka një ndarje interesash dhe secila nga palët heq dorë nga një pjesë e kërkesave të saj. Pra, interesat e palëve plotësohen pjesërisht, arrihet një kompromis, apo pajtueshmëri nëpërmes lëshimeve reciproke;

- ***situatë fitim-fitim***, nënkupton bashkëpunimin gjatë gjithë procesit të negociatave që rezulton në zgjidhje të mosmarrëveshjes si pasojë e hulumtimit të kryer, identifikimit të dallimeve ndërmjet palëve, krijimit të alternativave, d.m.th. një zgjedhje midis dy ose më shumë zgjidhjeve, e cila plotëson nevojat dhe interesat e palëve pjesëmarrëse në mosmarrëveshje²⁰. Vlen të potencohet edhe situata nëse palët nuk mund të pajtohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por pajtohen vetëm për faktet relevante në mosmarrëveshje. Në këtë rast, palët mund të bëjnë marrëveshje vetëm për faktet, në mënyrë që ato të mos jenë të nevojshme të provohen në procedurë gjyqësore apo në procedura tjera. Gjithsesi, e rëndësishme të veçantë është që ndërmjetësimi të jetë i suksesshëm, me një pajtueshmëri të plotë për të gjithë çështjet e hapura për të cilat palët janë të detyruara të nënshkruajnë. Marrëveshja e arritur me sukses hartohet nga palët apo nga ana e ndërmjetësit, me kërkesën e tyre. Marrëveshjes, palët mund t'i japin fuqi zbatimi, d.m.th. mund t'i japin marrëveshjes bazë mbi të cilën mund të kryhet drejtpërdrejt procedura e përmbartimit, duke e noterizuar

²⁰ Милорад Петревски, Медијација во Македонија,, Shkup, 2016, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2016/02/Medijacija.pdf>

atë. E njëjta vlen edhe nëse marrëveshja është arritur në mesin e procedurës gjyqësore që do të jetë bazë për zgjidhjen e pajtimit gjyqësor.

Ndërmjetësimi jo gjithmonë mund të jetë i suksesshëm. Në rastet e mossuksesit të kësaj procedure, palët mund ta ndërpresin atë në çdo kohë. Ndërprerjen e procedurës mund ta bëjë edhe ndërmjetësi, nëse konsideron se zhvillimi i mëtutjeshëm i procedurës është i pajustificuar, por fillimisht duhet të konsultohet me palët. Gjithashtu, ndërmjetësimi mund të përfundojë edhe me vdekjen e ndonjëres nga palët, apo me humbjen e cilësisë person juridik apo me humbjen e cilësisë ndërmjetësues të personit që e udhëheq procedurën. Në çdo rast, ndërmjetësimi përfundon 60 ditë pas fillimit të tij. Nëse ndërmjetësimi përfundon pa sukses, palët kanë të drejtë të vazhdojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre në gjykatë, arbitrazh ose procedurë tjetër²¹. Sipas Ligjit për ndërmjetësim parashihet që procedura e ndërmjetësimit përfundon brenda 60 ditëve nga dita e dhënies së deklaratës për fillimin e procedurës, pavarësisht nga rezultati i saj.

3. Strategjia për reformën e sistemit të drejtësisë (2017-2022)²² dhe ndërmjetësimi

Me miratimin e ndryshimit të LPK dhe me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në vitin 2015, u rit përqindja e procedurave në të cilat përdorej ndërmjetësimi. Numri më i madh i këtyre procedurave të ndërmjetësimit ka qenë i lidhur me mosmarrëveshjet e palëve në konteste ekonomike, pastaj konteste nga marrëdhënia e punës ndërsa konteste në numër më të vogël kanë qenë ata për sigurim. Plani strategjik i Ministrisë të Drejtësisë i vitit 2020-2022 parashikoi vetëm ndryshime të ligjit ekzistues për ndërmjetësim. Projektligji i ri për ndërmjetësimin u përgatit nga një grup pune i krijuar në Ministrinë e Drejtësisë, ku përfshihej drejtori i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, përfaqësues të sektorit joqeveritar, përfaqësues nga Dhoma e Ndërmjetësuesve, përfshirë edhe kryetari i Dhomës. Grupi i punës është krijuar më 11 nëntor 2020²³. Grupi i punës përpunoi versionin e projektligjit për ndërmjetësimin, i cili ishte përgatitur nga grupi i mëparshëm i punës në vitin 2018 dhe i cili nuk ishte miratuar nga përbërja e mëparshme parlamentare. Projektligji i ri për ndërmjetësimin është krijuar nga Qeveria e RSM më 1 qershor 2021 dhe ka qenë në procedurë parlamentare nga qershori 2021. Ligji i ri për Ndërmjetësimin u miratua nga Kuvendi i RSM më 23 dhjetor 2021, më shumë se dy vjet pas afatit të përcaktuar në planin e rishikuar të veprimit. Gjatë hartimit të projektligjit janë ndjekur përvojat evropiane, është

²¹ <https://www.akademik.mk/postapkata-za-medijacija-nekolku-fazi-do-prifatlivo-reshenie/>

²² Strategjia për Reformën e Sektorit të Drejtësisë 2017-2022 me Plan Veprimi, në dispozicion në <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20>

²³ https://www.pravda.gov.mk/resursi/12_63_akciski%20plan_MK-web.pdf

transpozuar direktiva 2008/52/KE për ndërmjetësimin në kontestet civile dhe ekonomike. Ligji i ri për Ndërmjetësimin i arrin qëllimet për të cilat është miratuar, d.m.th të rishikohet provimi për ndërmjetës dhe të futet një risi në lidhje me mënyrën e dhënies së provimit për ndërmjetës para komisionit, e cila do të ndikojë në krijimin e cilësisë, stafit profesional dhe të trajnuar, të cilët do të kryejnë me sukses punën në fushën e ndërmjetësimit. Më tej, parashikohet edhe mundësia e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit në mënyrë elektronike.

Ligji parashikon gjithashtu futjen e detyrueshme të të dhënave për rrjedhën e mëtejshme të procedurës, të cilat janë jashtëzakonisht të dobishme statistikisht dhe nga të cilat mund të gjenerohen parametrat e zbatueshmërisë dhe suksesit të ndërmjetësimit në praktikë. Kjo do t'i mundësojë ndërmjetësuesit, në bazë të rasteve të regjistruara në regjistër, të ushtrojë të drejtën për të zbatuar procedurat e ndërmjetësimit në nivel të duhur.

Kjo strategji mundësoi që me sjelljen në fuqi të Ligjit të ri për ndërmjetësim të hedhet një hap përpara jo vetëm në drejtim të përshpejtimit dhe efikasitetit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, por edhe në drejtim të zgjidhjes më moderne të mosmarrëveshjeve në përgjithësi. Me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësimit përfiton jo vetëm individët, por edhe shoqërinë në tërësi. Kjo procedurë është e rëndësishme dhe efektet e zbatimit të saj janë pozitive. Kjo metodë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës është më e thjeshtë, kërkon më pak kohë, kushton më pak, është e besueshme dhe nuk ka efekte negative. Rëndësia e kësaj procedure vërehet edhe në zvogëlimin e numrit të çështjeve gjyqësore dhe hapet hapësira që gjykatat të kryejnë detyrat e tyre edhe më me efikasitet dhe efektivitet.

Conclusion

From the brief elaboration of mediation it is clear that mediation is completely different from a classic court process. Today from mediation based on the practices of countries where it has achieved a strong implementation can be concluded that this procedure represents a respected and useful additional service that the parties can choose to resolve the dispute.

Mediation is a non-judicial activity in which the parties seek the resolving of a dispute through a third party, (the mediator), in order to reach an acceptable resolution of the dispute that does not conflict with the law.

The application of this procedure brings advantages both to the parties and to the judicial system in a given country and that:

- reducing the conflict between the parties and providing a quick effective solution;
- includes the parties to the process and the solving of disputes between them, not impose on them no decision-making about the process;
- there is a low cost of expenses for the parties;

- avoids lengthy court procedures;
- avoids blockage and problems in higher judicial instances;
- reduces corruption in the judiciary to a high degree;
- not only resolves the conflict, but normalizes, improves and regulates relations between the conflicting parties and creates premises for their continuation in the future, thus having happy faces and clasped hands, radically different from a court decision, which is a punitive decision, since one party wins and the other party loses;
- mediation is carried out through a civil, tolerant, non-stressful process, there is no lost side, there are no defendants and plaintiffs, but equal parties in resolving their conflict with understanding;
- with mediation, the punishments of minors are avoided, etc.

The most essential argument in favor of mediation derives from the idea of "justice and fairness", an idea formulated by Aristotle, which consists in the fact that in the mediation procedure the party observes what is right and the licensed mediator observes only the law, in order to let justice prevail.

Despite the fact that the Law on Mediation in North Macedonia has been approved since 2006 mediation is still at a stumble. With the entry into force of the New Law on mediation in 2022, mediation has influenced the awareness of experts and the general public about its advantages and the tendency of citizens to "seek justice, through this procedure". From this it can be concluded that in the future, emphasis should be placed on the greater promotion of this type of out-of-court resolving dispute by holding public debates and seminars. The promotion should be especially from the aspect of the easily of mediation for the resolving of legal-civil disputes, especially in the field of marital and family relations, as it ensures the overcoming of conflict situations, the cooperation and agreement of the parties in terms of accepting of the reached solutions.

This is extremely significant, especially from the point of view of protecting the rights and interests of children, in case of disputes regarding the exercise of parental rights during or after the divorce of the marriage. The resolving of family disputes through mediation is much more convenient and suits all family members, especially children, than the resolving of these types of disputes by court decision. Finally, it is worth concluding that based on the practices of the countries of the region and even more widely of the EU states, mediation should be introduced into the legislation as a mandatory procedure which the parties must implement it in order for the mediation to achieve the aforementioned advantages that speak of the triumph of justice and fairness in the judicial system.

Recensentë:

Prof.dr. Mitasin Beqiri

Prof.dr. Arlinda Kadri-Shahinoviq

Bibliografia

- 1) Вучев, З. Петковиќ, Г. Атанасова, Д. Јанкова, „Прирачник за обука на медијатори за обновување на знаењата за медијација”, Институт за европска политика - Shkup 2013
- 2) Direktiva 2008/52/EC Nr.CELEX 3200810052 e Parlamentit European dhe Këshillit European të 21 Majit 2008 “Mbi disa aspekte të Ndërmjetësimit në çështjet civile dhe ekonomike”
- 3) Кирил Чавдар& Кимо Чавдар - Закон за парнична постапка со коментари, судска практика, примери од практична примена и предметен регистар, Shkup, 2016.
- 4) Ligji për ndërmjetësim në RM, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.60/2006
- 5) Ligjit për ndërmjetësim i RMV, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 294/2021
- 6) Ligjit për familje i Malit të Zi, Gazeta zyrtare, nr.1/07.
- 7) Ligji për ndryshim dhe plotësimin e procedurës kontestimore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 124./15
- 8) Ligji për ndërmjetësim i RM-së “ Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 188/2013
- 9) Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09.
- 10) Ligji për procedurën kontestimore i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 79/05, 110/08, 83/09 , 116/10, 124/15.
- 11) <https://www.akademik.mk/mirno-reshavanje-na-sporovi-obrazets-za-barane-za-medijatsija-i-obrazets-za-polnomosh-no-zastapuvane/>
- 12) Роза Алексова (медијатор), Неколку корисни информации за постапката на медијација во Македонија, [https:// goo.gl/UxVj5e](https://goo.gl/UxVj5e)
- 13) Милорад Петревски, Медијација во Македонија,, Shkup, 2016, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2016/02/Medijacija.pdf>
- 14) <https://www.akademik.mk/postapkata-za-medijacija-nekolku-fazido-prifatlivo-reshenie/>
- 15) Strategjia për Reformën e Sektorit të Drejtësisë 2017-2022 me Plan Veprimi, në dispozicion në <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategija%20i%20>
- 16) https://www.pravda.gov.mk/resursi/12_63_akciski%20plan_MK-web.pdf